



Republika e Kosovës
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
Departamenti shërbimeve këshillimore teknike
Department of Technical and Advisory Services
Departmend za tehničke i savjetodavne usluge



Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës
Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services
Poljoprivredna Ruralna Savetodavna Služba Kosova

Mesazhi këshillues për fermerët !
“Mbjellja e qepës ne fushë te hapur”.

Qepa: Qepa është nga bimët më të vjetra perimore, qepen e kanë prodhuar edhe popujt e lashtë (grekët, Egjiptasit etj). të cilët përveç që e kanë shfrytëzuar për ushqim e kanë përdorur mjaft shumë edhe si bimë mjekuese.

Në Kosovë, si për nga madhësia e sipërfaqeve të mbjella, po ashtu edhe nga niveli i përdorimit në ushqim është ndër bimët kryesore perimore.



Kërkesat e qepës ndaj temperaturës; Qepa ka kërkesa të vogla ndaj temperaturës. Temperature minimale për mbirje është +2 - +5°C, temperature optimale 18 - 20°C ndërkaq maksimalja rreth 30°C. në fazën e rritjes intensive të gjethëve dhe fillimit të formimit të bulbit temperature minimale duhet të jetë 15°C, ndërkaq optimalja sillet rreth 22°C.

Kërkesat e qepës ndaj lagështisë: Varësisht nga faza e rritjes dhe zhvillimit në të cilën gjendet bima kërkesat janë të ndryshme. Kërkesat më të mëdha për lagështi janë në fazën e mbirjes dhe deri në përfundimin e fazës së rritjes intensive të gjethëve (formimi i plotë i bulbit) ndërkaq në fazën e pjekjes kërkesat ndaj lagështisë zvogëlohen mjaft shumë. Deri në formimin e bulbit KFU I tokës duhet të jetë 70 - 80 %, ndërkaq në fazën e formimit të bulbit 50 - 60 % të KFU.

Kërkesat e qepës ndaj tokës; Qepa rritet më së miri në tokat me reaksion neutral (PH 6,8 - 7,5) nuk i përballon reaksionit acidik të tokës

Kultivimi i qepës; Mënyra e kultivimit të qepës varet nga tradita e përvetësuar nga ana e prodhuesve, qëllimi i prodhimtarisë varietetit-hibridi etj. Në kushtet tona kultivimi i qepës bahet kryesisht përmes qepujkave, më rrallë edhe me mbjellje drektë të farës, ndërsa kultivimi përmes fidanit është pothuajse i pa njohur. Parakusht kryesor i prodhimtarisë së suksesshme të qepës përmes qepujkave është cilësia e qepujkave të cilat prodhohen në vitin e parë.

Përgatitja e tokës për mbjellje dhe përdorimi i plehut ; Përgatitja fillon në vjeshtë me punimin themelor me ç 'rast hidhet edhe një sasi e plehrave P250 dhe K20. Në pranverë sa më herët që të jetë e mundur bëhet përgatitja e tokës për mbjellje (ndërrimin) e qepujkave me ç 'rast bëhet edhe hedhja e plehrave minerale (rëndomtë në formë të kombinuar NPK). Raporti në mes këtyre elementeve është e preferuar te jete 1:1:1. në tokat mesatarisht të pasura sasi të orientuese të plehrave minerale në formë të materieve aktive kishin me qenë 60 - 70 [kg N /ha], 120 - 150 [kg P205 /ha] kurse në tokat e varfra mund të jepet edhe një sasi e K₂O në sasi 100 - 150 [kg /ha].

Mbjellja e qepujkave; Mbjellja e bëhet në pranverë, mars - prill. Mbjellja e mëvonshme ndikon mjaft shumë në zvogëlimin e rendimentit. Për mbjellje më të përshtatshme janë qepujkat e madhësisë 1 - 2 cm, mbjellja bëhet në rende në distancë 15 x 15 cm, 20 x 8 - 10 cm etj.

Sasia e qepujkave për mbjelljen e 1 ha, është e ndryshme varësisht nga madhësia e tyre dhe sillet nga 300 - 1000 kg/ha. Për qepujkat e vogla është 300 - 500 [kg], qepujkat me madhësi mesatare 500 - 700 [kg], ndërsa për qepujkat e mëdha [kg/ha]. Megjithatë si vlerë mesatare rëndomtë merret se për një [ha] mesatarisht nevojiten 500 - 600 - [kg] qepujka për mbjellje.

Masat e përkujdesjes; Gjatë vegjetacionit përkujdesja bazohen në kultivimin e rregullt të bimëve në mes rendeve eliminim e barojave, mbrojtjen nga dëmtuesit, në rastet e mungesës së lagështisë është e preferuar që të bëhet edhe ujitja e bimëve

Tek ujitja duhet pasur kujdes që pas formimit të bulbit ato të ndërpriten (pasi që mund të ndikojnë në zgjatjen e vegjetacionit).



Ku mund te merrni informata shitesë:

Për informata shitesë mund te kontaktoni këshilltarët komunal ku ne secilën komune mund te lajmëroheni ne Drejtorinë - zyrën për bujqësi, ose ne zyrën qendrore te shërbimit këshillimor, si me poshtë;

Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike, MBPZHR

Rr. "Ukshin Hoti", ndërtesa e ish Ramiz Sadikut, nr 120 Kati III, Prishtinë – Kosova
Tel. 383- (0)3820038426